



Prishtinë, 17 dhjetor 2021
Kodi i ZRRE-së: V_1462_2021

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, Nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, Nenin 25, Nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe Nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 25 të Rregullës Nr. 11/2017 për Procedurën e Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja bazuar në Burimet e Ripërtrithshme të Energjisë;
- Nenin 18, 19 dhe 20 të Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse për Gjeneratorët e BRE-ve, dhe
- Aplikacionin për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë - konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në objektin në parcelën ngastrave kadastrave Nr. 00830-0 dhe Nr. 00831-0 ZK Radivojcë/Viti, me kapacitet të instaluar prej 100 kW në Komunën e Vitisë, e pranuar me nr. Prot. 557/21 të datës 01.12.2021 nga aplikuesi "EURO FISI" SH.P.K., me adresë: fsh. "Radivojcë" Komuna e Vitisë, Republika e Kosovës,

në seancën e mbajtur më 17 dhjetor 2021 nxori këtë:

V E N D I M

PËR NDËRTIMIN E KAPACITETEVE GJENERUESE PËR VETË-KONSUM

- I. **APROVOHET** - kërkesa e aplikuesit "EURO FISI" SH.P.K., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike në objektin në parcelën ngastrave kadastrave Nr. 00830-0 dhe Nr. 00831-0 ZK Radivojcë/Viti, me kapacitet të instaluar prej 100 kW në Komunën e Vitisë.
- II. **OBLIGOHET** – aplikuesi "EURO FISI" SH.P.K., me shifër të regjistruar të njehsorit elektrike DGL-9028400 që pas ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë-konsum, të parashtror kërkesë në KEDS SH.A., për pranim teknik të objektit energjetik.
- III. ZRRE do të konsideroj projektin e finalizuar nga data e pranimit teknik sipas Pëlqimit Elektroenergjetik të lëshuar nga KEDS SH.A.
- IV. Aplikuesi "EURO FISI" SH.P.K., do të lidh Marrëveshje për vetë-prodhim me furnizuesin me të cilën ka kontratë për furnizim me energji elektrike, pas konfirmimit të pranimit teknik nga KEDS SH.A., në pajtim me nenin 18 paragrafi 1 dhe 2 i Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse.

Arsyetim



- ZRRE, me datë 01.12.2021 nga aplikuesi "EURO FISI" SH.P.K., ka pranuar aplikacionin për marrjen e vendimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike në objektin në parcelën ngastra kadastrave Nr. 00830-0 dhe Nr. 00831-0 ZK Radivojcë/Viti, me kapacitet të instaluar prej 100 kW në Komunën e Vitisë.
 - Aplikuesi, s'bashku me aplikacionin ka bashkangjitur edhe dëshminë nga KEDS për konsumin vjetor të energjisë elektrike, vlerësimin për prodhimin vjetor në kW/h të pajisjeve të instaluara, pëlqimin elektroenergjetik Nr. 9633 të datës 20.09.2021 të lëshuar nga KEDS SH.A., dhe Pëlqimin Nr. 11-320/04-4278434/1 i dt. 25.11.2021 të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizim, Planifikim dhe Mjedis e Komunës së Vitisë.
 - Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të kërkesës së aplikuesit "EURO FISI" SH.P.K., dhe dëshmime të bashkangjitura, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë - konsum nga panelet solare/fotovoltaike në objektin në parcelën ngastra kadastrave Nr. 00830-0 dhe Nr. 00831-0 ZK Radivojcë, me kapacitet të instaluar prej 100 kW në Komunën e Vitisë, ka vlerësuar ato, dhe ka konsideruar se janë plotësuar të gjitha dëshmitë relevante për lëshimin e vendimit për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese për vetë-konsum, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.
- V. Vendimi nixirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Vendimi iu dërgohet:

- Palës,
- Komunës së Vitisë,
- KEDS SH.A.,
- KESCO dhe
- Arkivit të ZRRE-së


Bordi i ZRRE-së:


Ymer Fejzullahu, Kryesues


Selman Hoti, anëtar


Izet Rushiti, anëtar


Lutfije Dervishi, anëtare


Gani Bucaj, anëtar